



PRS.0014

## CLAYSEAL 25.20

Ujë-blokuuese me bazë bentoniti të natriumit dhe gomë hidroekspansive

### Kodi doganor

4006 9000

### Ambalazhimi

- Kuti: 6 x (Rrotull 5 m)
- Koli: 48 x (Kuti 21 Kg)

### Aplikimi

- Çekiç
- Aplikim manual

Familja  
Proseal

Linjat e produkteve

- Aqua
- Infratech
- Sanageb

Përbërësit  
Monokomponent

Tipologjia

Produkte hidroekspansive me bazë bentoni të natriumit

Kategoritë e përdorimit

- Hidroizolim i ambienteve nëntokësore me produkte hidroekspansive
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje për diga, vaska, ujësjellësa dhe kanalizime hidrike
- Ndërhyrje strukturore mirëmbajtjeje të tuneleve dhe galerive
- Realizimi i veprave nëntokësore në beton me papërshkueshmëri të lartë

Paraqitja  
Bordurë

## Certifikimi dhe rregulloret



### Sanageb - Prodotto naturali per la Bioedilizia

Produkti i linjës Sanageb, linja e produkteve të Azichem Srl e dedikuar që nga viti 1994 për produktet e dedikuara për ndërtimet e ndërtesat ekologjike (green building), për restaurimin ekologjik, izolimin termik dhe kursim të energjisë.

## Përshkrimi i produktit

Lidhje hidroizoluese për ndalimin e ujit, e parapërgatitur, për nyje ndërtimi me mbyllje hermetike në struktura, muratura dhe themele, e realizuar me një përzierje të bentonitit të natriumit, zgjerimit të gomës dhe polimereve të veçantë agregues ("hidrokarbur"). CLAYSEAL 25.20 ka një seksion drejtkëndor prej 25x20 mm, e paketuara në rrotulla prej 5 m secili.

## Të dhëna shtesë


CLAYSEAL 25.20 është një ujë-blokuues prej betoniti të natriumit që përdoret shumë thjeshtë dhe me aplikohet me shumë lehtësi; nuk kërkon përgatitje të veçanta të shtresave mbështetëse, kallëpe të parapërgatitura etj. Fiksohet lehtësisht përmes gozhdimit apo ngjitjes (me ngjitesin e posaçëm PROSEAL FIX) dhe nuk kërkon masa të veçanta mbrojtëse. Në kontakt me ujin, e zgjeron volumin e vet nëpërmjet formimit të një sistemi koloidal të qëndrueshëm që garanton mbylljen e përhershme të lidhjes; zgjerimi fillestar vonohet përmes veshjes së vonuar në krahasim me kontaktin e parë me ujin, në mënyrë që të lejojë mungesën e deformimeve në fazën fillestare të forcimit të betonit të freskët.


## Fushat e përdorimit


Realizim nyjesh të forta (jo zgjeruese) dhe lidhjesh me një qëndruesë të sigurtë dhe të përhershme hidraulike.


## Vetitë kryesore

 Jetëgjatësia:  
12 muaj

 Peshë specifike:  
1.4-1.5 kg/dm<sup>3</sup>

 Produkt hidroekspansiv:  
+350 %

 Temperatura e aplikimit:  
-15 / +50 °C

 Ngjyrat në dispozicion  
E zezë

## Veçoritë teknike

Lëndë pa aromë

Përmbajtja e betonitit të natriumit: > 60 %

Peshë tërësore (ASTM D71): 0.67 kg/m

Rezistenca nga zjarrit DIN 4102-1: B 2 \_

Tërheqja deri në këputje: 60 %

Zgjerim deri në 7 gg me pH 12,33: 110 %

Zgjerimi deri në 7 gg me pH 7: 250 %

IF YOU WANT TO SOLVE IT  
 azichem

www.azichem.com

Përditësimi më: 11/09/2019  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
www.azichem.it/disclaimer

## Mënyra e përdorimit

Përhapni me dorë ujë-bllokuesin prej betoniti të natriumit CLAYSEAL 25.20 në pozicionin e parashikuar.

Fiksimi bëhet përmes gozhdimit: një gozhdë çeliku dhe një rondelë çdo 20-25 cm afërsisht. Bllokimi i nyjeve mes bordurave të ujë-bllokuesit sigurohet thjesht nga afrimi me të paktën 10 cm dhe jo nga mbivendosja e skajeve.

Për situata aplikimi veçanërisht të ndërlikuara, është në dispozicion rrjeta e veçantë në fije çeliku BENTONET, me thurje katrore prej 13x13 mm, me profile prej 1 metri secili.

## Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Nëse parashikohet shtrimi i bordurës së bentonimit nëpërmjet gozhdimit, përgatiteni dyshtresën ku do të vendoset që të jetë sa më e sheshtë dhe më e lëmuar që të jetë e mundur, duke ngjeshur çrregullimet e mundshme me REPAR TIX. Në do rast, hiqni me shumë kujdes pjesët e copëtuara, të papërshtatshme, me pluhur.

## Magazinishimi e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarimin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Mbrojeni nga lagështia.



## Ekstrakt nga raporti eksperimental i testit

Më poshtë është një ekstrakt i komentit përmblendës të raportit të provave eksperimentale të kryer nga Laboratori Cisoni Srl i Cuneo, me kodin 135 / CHI / 15/09/0252 të datës 06.04.2009:

*Testet laboratorike kanë treguar se CLAYSEAL 25.20 ka një rritje të vëllimit në kontakt me ujin prej 243.4%; vlera duhet të konsiderohet e lartë dhe më shumë se e mjaftueshme për funksionin që duhet të kryejë. Sipërfaqja e mostrës mbetet e lëmuar, kompakte dhe pa çarje. Konstruksioni është rezistent ndaj zgjerimit, kështu që CLAYSEAL 25.20, përballë rritjes së lartë të volumit, do të ushtrojë një presion të mirë zgjerimi duke parandaluar depërtimin e ujit në pikat e lidhjes. Rritja e volumit në pH 12.33 është 110.4%, një vlerë më e lartë kjo se parametri minimal i rritjes së volumit (100%). Edhe në pH 12 sipërfaqja e mostrës mbetet e pandryshuar dhe pa çarje. CLAYSEAL 25.20 është një produkt i përshtatshëm për përdorim në një mjedis bazik, në kontakt me beton të freskët dhe beton të ngurtësuar).*



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **11/09/2019**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)

## Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënët teknike dhe përdorimet e renditura në këtë dokument janë rezultat i provave teknike të realizuara në laboratorë me tempetarura të kushtëzuara, dhe si të tilla mund të ndryshojnë në mënyrë të ndjeshme prej kushteve të veprimit dhe të zbatimit. Për këtë arsye është e nevojshme të kryhen prova paraprake në kushtet konkrete të përdorimit.

Përdoruesi duhet të ketë parasysh që të lexojë Skedën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së produktit, ku përmbahen të dhënat kimiko-fizike dhe toksikologjike, fazat e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim transportimin, përdorimin dhe shkatërrimin e produktit dhe paketimin e tij duke respektuar sigurinë. Gjithësesi duhet të mbahet parasysh që të mos shpërndahet produkti dhe ambalazhimi i tij në ambient.

Pozicionimi duhet të garantojë një mbulim prej 10-12 cm nga betoni në mënyrë që të përmbajë veprimin e zgjerimit që krijohet nga hidratimi. Në të njëjtën mënyrë, shpërndarësit e kasetave duhet të jenë të pozicionuar në mënyrë të tillë që të ruajnë një distancë minimale prej 8 cm nga vetë bordura prej bentoniti.

Megjithëse produkti ka një zgjerim të vonuar prej 48h, përdorimi i tij nuk rekomandohet në rastet e stuhive të parakohshme ose kur lagështia është e tepërt (apo në prani të pellgjeve). Në rastin e ujërave nëntokësore me përmbajtje të lartë të kripës ose për të ndaluar ujin e kulluar dhe ujërave të ndotura, kryeni teste të zgjerimit paraprak ose kërkojnë ujë-bllokues specifikë CLAYSEAL 25.20 SW.

*CLAYSEAL 25.20 prodhohet/shpërndahet nga*



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali  
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



[www.azichem.com](http://www.azichem.com)

Përditësimi më: **11/09/2019**  
Kushtet e shitjes dhe parashikimet  
ligjore mund të lexohen në  
[www.azichem.it/disclaimer](http://www.azichem.it/disclaimer)